



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 30 (827935)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 1 gusht 2025

NGA BETIMI TE PËRGGJEGJËSIA 90 oficerë të rinj i bashkohen Forcave të Armatosura



faqe 3



ZJARRET, QEVERIA SHPALL MBËSHTETJE PËR TË PREKURIT MINISTRI VENGU: RRISIM INVESTIMET PËR FLOTËN AJRORE DHE KAPACITETET TOKËSORE

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, gjatë një takimi koordinues me drejtues të dikasterëve të tjera shtetërore, ka bërë të ditur bilancin e ndërhyrjeve për përballimin e emergjencës së shkaktuar nga zjarret masive në vend. Në takim ishin të pranishëm edhe ministri i Brendshëm Ervin Hoxha, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj dhe drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako...



faqe 4



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI PRITI GJENERALMAJORIN ITALIAN NICOLA PIASENTE: ITALIA, AKTOR KYÇ PËR STABILITETIN NË RAJON

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim zyrtar gjeneralmajor Nicola Piasente, zëvendës shef i Shtabit për Planet në Komandën Italiane për Operacionet e Përbashkëta. Vizita e gjeneralmajor Piasente në vendin tonë u realizua në kuadër të Konferencës së Gjenerimit të Forcës për Iniciativën e Forcës Tokësore...



faqe 5



NËN FLAKËT E KORRIKUT: KUR UNIFORMA E USHTARAKUT U BË MBUROJË NDAJ ZJARRIT

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Korriku i këtij viti mbërriti i nxehtë, i paepur, me frymë të rëndë dhe stuhi flakësh që përfshinë malet, kodrat dhe shpirtin e çdo shqiptari. Nuk ishte hera e parë që vendi ynë përballëj me zjarre, por këtë herë gjithçka kishte tjetër përmasë: mbi 70 vatra aktive në të njëjtën kohë, në të gjithë vendin, nga veriu në jug, nga lugina e Gjirokastrës te kodrat e Lezhës...



faqe 7



NGA BETIMI TE PËRGJEGJËSIA 90 oficerë të rinj i bashkohen Forcave të Armatosura

Në një ceremoni solemne të zhvilluar në kompleksin e ri sportiv të garnizonit "Skënderbej", 90 studentë/kadetë të Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) bënë betimin ushtarak para Flamurit Kombëtar, duke u bërë pjesë e trupës së re të oficerëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Mes tyre, edhe pesë studentë nga Kosova, të cilët u diplomuan me sukses në këtë institucion të rëndësishëm ushtarak.

Në këtë ngjarje të veçantë ishin të pranishëm personalitete të larta të mbrojtjes dhe sigurisë nga Shqipëria dhe Kosova, përfshirë ministrin e Mbrojtjes të Shqipërisë z. Pirro Vengu, ministrin e Mbrojtjes të Kosovës z. Ejup Maqedonci, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, gjenerallejtënant Arben Kingji, gjeneralë, atashe ushtarakë, anëtarë të Komisionit Parlamentar të Sigurisë, pedagogë të AFA-së dhe familjarë të kadetëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, vlerësoi këtë moment si një ngjarje me rëndësi kombëtare:

"Çdo herë që një brez i ri vesh uniformën, shteti shqiptar rifillon, forcohet dhe përtërihet", – u shpreh ministri Vengu. Ai theksoi më tej se Forcat e Armatosura nuk janë thjesht një dekor simbolik i



“ MINISTRI VENGU: ÇDO HERË QË NJË BREZ I RI VESH UNIFORMËN, SHTETI SHQIPTAR RIFILLON, FORCOHET DHE PËRTËRIHET



shtetit, por përfaqësojnë “kockën, muskujt dhe ndërgjegjen” e tij, duke sjellë në vëmendje rolin e efektivëve në përballimin e emergjencave natyrore, veçanërisht zjarreve

që kanë prekur vendin gjatë vitit: “Ata nuk bënë vetëm detyrën. Ata treguan atë që në rrethana normale quhet vetëpërmbytje, por në rrethana të jashtëzakonshme, quhet

heroizëm i heshtur”.
Ministri prezantoi gjithashtu pesë shtyllat kryesore të Strategjisë “Shqipëria 2030” për mbrojtjen kombëtare, të cilat përfshijnë:

zhvillimin e industrisë vendase të mbrojtjes “Made in Albania”; aplikimin e inovacionit dhe teknologjisë; modernizimin operacional dhe logjistik; forcimin e kapaciteteve të integruara dhe kontributin në sigurinë rajonale e globale.
Në fjalimin e tij, ministri falënderoi edhe familjarët dhe pedagogët për mbështetjen e tyre: “Shqipëria nuk është më një vend që pret të mbrohet. Shqipëria mbron! Shqipëria kontribuon! Shqipëria përgatitet!”.
Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, në fjalën e tij theksoi rëndësinë morale dhe ligjore të betimit ushtarak: “Betimi ushtarak para Flamurit Kombëtar nuk është thjesht një tekst, por një angazhim moral, ligjor dhe atdhetar për të qenë gjithmonë në shërbim të kombit”.
Nga 90 të diplomuarit, 53 përfunduan studimet Bachelor në programe të ndryshme si Shkenca Ushtarake, Navigim Detar dhe Teknologji Informacioni në fushën e Mbrojtjes. Ndërsa 37 kadetë përfunduan me sukses Kursin njëvjeçar të Përgatitjes së Oficerit.
Ceremonia përmbylli me krenari një etapë të rëndësishme për këta të rinj, të cilët tashmë do të mbajnë mbi supë përgjegjësinë dhe nderin për të shërbyer me përkushtim në radhët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë.



ZJARRET, QEVERIA SHPALL MBËSHTETJE PËR TË PREKURIT

Ministri Vengu: Krisim investimet për Flotën Ajrore dhe kapacitetet Tokësore

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, gjatë një takimi koordinues me drejtues të dikastereve të tjera shtetërore, ka bërë të ditur bilancin e ndërhyrjeve për përballimin e emergjencës së shkaktuar nga zjarret masive në vend. Në takim ishin të pranishëm edhe ministri i Brendshëm Ervin Hoxha, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Anila Denaj dhe drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Haki Çako.

Në fokus të diskutimeve ishte vlerësimi i gatishmërisë operationale për emergjencat civile, menaxhimi i dëmeve dhe mbështetja për banorët e prekur, me theks të veçantë në sektorin e blegtorisë.

Ministri Vengu bëri me dije se vetëm gjatë muajit korrik janë regjistruar 59 zjarre masive dhe dhjetëra të tjerë më të vegjël, të cilët kanë shkaktuar djegien e mbi 29 mijë hektarëve. Zonat më të prekura janë Vlora me 17.500 ha, Dibra me 4.524 ha, Tirana me 2.400 ha dhe Berati me 1.500 ha. Krahasimisht, Shqipëria kishte një rekord historik më 2007 me 127 mijë ha të djegur, ndërsa këtë vit, shifra mesatare e zjarreve ka arritur në 13 në javë, dyfishi i viteve të mëparshme.

Në përgjigje të kësaj situatë, 14.200 forca operationale, 2.000 mjete të specializuara dhe 63 operatione ajrore janë angazhuar për shuarjen e zjarreve. Për herë të parë, Shqipëria ka pasur në dispozicion një numër rekord mjetesh ajrore, përfshirë 4 helikopterë shqiptarë, si dhe mjete të ofruara nga Hungaria, Italia, Greqia dhe Kroacia.

“Janë evituar fatkeqësitë në jetë njerëzish



dhe dëmet janë minimizuar falë reagimit të koordinuar. Deri tani janë raportuar të dëmtuara 12 banesa, 3 stane, një objekt kulti dhe një nënstacion energjie”, – deklaroi ministri Vengu, duke shtuar se do të vijojë investimi për modernizimin e Flotës Ajrore dhe kapaciteteve Tokësore.

Ministrja e Bujqësisë, Anila Denaj, informoi se dëmet më të mëdha në sektorin rural janë regjistruar në jug të vendit, kryesisht në Delvinë, ku janë prekur blegtoria, bletaria dhe kullotat. Sipas saj, po vlerësohet nevoja për mbështetje me bazë ushqimore për kafshët dhe furnizimi është bërë i mundur në kohë rekord në disa prej zonave të prekura. Nga ana e tij, ministri i Brendshëm, Ervin Hoxha, deklaroi se Policia e Shtetit ka proceduar 120 persona, ndërsa 21 prej tyre janë arrestuar për zjarrvënie të qëllimshme ose për shkak të pakujdesisë.

Ministrat theksuan se edhe muaji gusht paraqitet si një sfidë për strukturat e emergjencës dhe kërkuan vigjilencë maksimale dhe reagim të menjëhershëm, për të shmangur përshkallëzimin e situatës. Ushtria, në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore, vijon të jetë në gatishmëri të plotë për përballimin e çdo emergjence civile.



Forca Ajrore, në vijë të parë kundër zjarreve: Vlerësim për përkushtimin dhe kontributin vendimtar në operationet ajrore

Përballë situatës së vështirë të krijuar nga përhapja e vatrave të zjarrit në disa rajone të vendit, Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë ka luajtur një rol vendimtar në menaxhimin dhe shuarjen e emergjencave. Misionet ajrore kanë qenë të pandërprera, me qëllim mbështetjen e forcave tokësore në zonat malore dhe të paarrtshme, ku ndërhyrja nga toka është thuajse e pamundur. Kreu i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, ka vlerësuar lart kontributin e Forcës Ajrore, duke shprehur një falënderim të veçantë për komandantin e Bazës Ajrore të Farkës, nënkolonel Ervin Buzi dhe gjithë stafin ajror të angazhuar pa ndërprerje në operatione: “Falënderim i veçantë për Forcën Ajrore të Shqipërisë, për nënkolonel Ervin Buzin dhe ekipin e Bazës Ajrore të Farkës, të cilët me përkushtim, profesionalizëm dhe sakrificë janë gjendur në çdo moment në mbështetje të qytetarëve dhe strukturave operationale në terren. Angazhimi i tyre ka qenë vendimtar në menaxhimin e situatave më kritike”, – deklaroi z. Çako.

Komandanti i Bazës Ajrore, nënkolonel Ervin Buzi, theksoi se gatishmëria ka qenë maksimale, pavarësisht kushteve të vështira të fluturimit dhe lodhjes së akumuluar nga operationet e vazhdueshme: “Ekipet tona kanë qenë në gatishmëri të vazhdueshme, të gatshme për ndërhyrje në çdo moment, pavarësisht kushteve të vështira dhe lodhjes. Ky është misioni ynë – të jemi aty ku nevojitet, orë pa orar”. Në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, Shqipëria përfitoi gjithashtu mbështetje nga vendet partnere. Hungaria kontribuoi me helikopterë për operationet nga ajri, duke dëshmuar solidaritet dhe reagim të shpejtë përballë situatës emergjente. Misioni i tyre në Shqipëri përfundoi me sukses, duke u vlerësuar nga autoritetet shqiptare për ndihmën konkrete dhe bashkëpunimin e frytshëm.

Ky operation nxori në pah jo vetëm angazhimin e jashtëzakonshëm të Forcës Ajrore shqiptare, por edhe bashkëpunimin efikas ndërkombëtar në kuadër të mbrojtjes civile, duke forcuar kapacitetet dhe gatishmërinë për përballimin e emergjencave të natyrës në të ardhmen.

Forca Ajrore, në mision të pandërprerë për shuarjen e zjarreve: Bashkëpunim i ngushtë me strukturat vendore dhe partnerët ndërkombëtarë

Forca Ajrore e Republikës së Shqipërisë vijon pa ndërprerje angazhimin në operationet ajrore për përballimin e situatës së krijuar nga vatrave të zjarrit që kanë përfshirë disa zona të vendit. Në koordinim të ngushtë me strukturat e Mbrojtjes Civile, Forcat e Armatosura, autoritetet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, misionet ajrore janë duke u zhvilluar me intensitet të lartë dhe në kushte të vështira. Dy helikopterë të Forcës Ajrore u përfshinë në operationet në zonat e Borshit, Piqerasit dhe Sasajt, ku për shkak të erërave të forta, flakët janë përhapur me shpejtësi, duke rrezikuar banesa dhe struktura ekonomike. Ndërhyrja nga ajri ka synuar frenimin dhe izolimin e përhapjes së mëtejshme të zjarrit në një territor me rëndësi të veçantë për turizmin dhe komunitetin lokal. Operationet janë kryer në kushte të vështira terreni dhe moti, me përkushtim të lartë nga ekipet ajrore. Po ashtu, helikopterë të Forcës Ajrore janë angazhuar edhe në zona të tjera problematike si Zhulati, në qarkun Gjirokastrë, dhe Qafa e Buallit, pranë Bulqizës, në bashkërendim me forcat tokësore dhe njësitë zjarrfikëse. Në kuadër të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian, Shqipëria ka përfituar ndihmë nga partnerët ndërkombëtarë. Një avion zjarrfikës i tipit “Canadair” CL-415, i dërguar nga Italia, ka mbërritur dhe është aktivizuar në jug të vendit, veçanërisht në segmentet malore të Borshit dhe Lukovës, ku ndërhyrja ajrore ishte jetike për mbrojtjen e zonave të banuara. Ndërhyrjet ajrore u zhvilluan në koordinim të ngushtë me strukturat tokësore të emergjencave civile, autoritetet vendore dhe zjarrfikësit në zonat më të prekura si Rrëshen, Mirditë dhe Bulqizë. Ky bashkëpunim ndërinstitucional siguroi një reagim të unifikuar dhe efikas, duke bërë të mundur ndërhyrjen e menjëhershme nga ajri në mbështetje të përpjekjeve nga toka. Forca Ajrore mbetet e angazhuar maksimalisht në misionin e saj për garantimin e sigurisë publike dhe përkrahjen e operationeve të mbrojtjes civile. Kapacitetet ajrore janë vënë në dispozicion të emergjencave në çdo moment, duke përmbushur detyrën me përkushtim dhe profesionalizëm. Pilotët dhe ekuipazhet ajrore të Forcës Ajrore demonstrian guxim dhe vendosmëri, duke operuar pa orar në kushte të vështira, për të mbrojtur jetën, pronën dhe natyrën e vendit tonë. Përmes këtij angazhimi të jashtëzakonshëm, Forca Ajrore dëshmon rolin thelbësor në arkitekturën e reagimit emergjent në Shqipëri.



Gjenerallejtënant Arben Kingji priti gjeneralmajorin italian Nicola Piasente: Italia, aktor kyç për stabilitetin në rajon

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në një takim zyrtar gjeneralmajor Nicola Piasente, zëvendëshef i Shtabit për Planet në Komandën Italiane për Operacionet e Përbashkëta. Vizita e gjeneralmajor Piasente në vendin tonë u realizua në kuadër të Konferencës së Gjenerimit të Forcës për Iniciativën e Forcës Tokësore të Përparuar të NATO-s në Bullgari, e cila këtë vit u mbajt në Shqipëri.

Gjatë takimit, gjenerallejtënant Kingji vlerësoi angazhimin e vazhdueshëm të Italisë në sigurinë rajonale dhe në strukturat ndërkombëtare të sigurisë.

“Dua të adresoj një vlerësim të veçantë për rolin e çmuar të Italisë, e cila aktualisht drejton misionin KFOR, udhëheq EULEX-in, ka pozicionin e zëvendëskomandantit në misionin ALTHEA dhe në vitin 2026 do të marrë komandën e plotë të këtij misioni. Këto angazhime e bëjnë Italinë një aktor kyç për stabilitetin e rajonit”, – deklaroi kreu i SHSHPPFA-së.

Gjenerallejtënant Kingji theksoi gjithashtu mbështetjen e Shqipërisë për misionet ndërkombëtare të NATO-s dhe të BE-së:



“Shqipëria mbështet plotësisht misionet KFOR dhe ALTHEA si pjesë e angazhimit tonë për paqen dhe sigurinë në rajon”.

Një pikë kyçe e diskutimit ishte prania e NATO-s në Bullgari, ku Italia ka rolin drejtues të Forcave Tokësore të Përparuara (FLF BGR), dhe ku Shqipëria po kontribuon me personel ushtarak. “Ne mbështesim fuqimisht kalimin e prezencës së NATO-s në Bullgari nga format grup-batalion në Brigadë Shumëkombëshe, në përballje me qëndrimin agresiv të Rusisë ndaj Aleancës”, – u shpreh më tej Kingji.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Piasente shprehu mirënjohje për mikpritjen dhe kontributin e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare dhe në sigurinë kolektive të NATO-s. Ai vlerësoi veçanërisht rolin e Shqipërisë si vend pritës i Konferencës së Gjenerimit të Forcës, ku përfaqësuesit nga vendet kontribuuese diskutuan për sfidat dhe angazhimet e ardhshme të FLF BGR, si dhe për kalimin nga batalion në brigadë.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vijojnë të jenë të angazhuara dhe kontribuuese aktive në arkitekturën e sigurisë kolektive të NATO-s, duke dëshmuar përkushtimin e vendit tonë ndaj Aleancës dhe partneritetit strategjik me Italinë.



Forcat e Armatosura në vijën e parë të betejës me zjarret

Shqipëria po përballlet me një situatë të rënduar nga zjarret në disa qarqe të vendit, duke përfshirë Lezhën, Kukësin, Dibrën, Elbasanin, Vlorën, Gjirokastrën, Sarandën dhe zona të thella rurale në Mat, Bulqizë dhe Korçë. Përballë këtyre emergjencave, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë angazhuar pa ndërprerje në operacionet e shuarjes dhe menaxhimit të situatës.

Qindra efektivë të FA-së, të pajisur me dhjetëra mjete tokësore dhe me mbështetjen ajrore të helikopterëve të Forcës Ajrore, po punojnë intensivisht në terren në bashkëpunim të ngushtë me strukturat vendore dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, ndoqi nga afër operacionet në disa nga zonat më të prekura, përfshirë: Kulmë, Mirditë Shkopet, Kurbin, Zall-Gjocaj, Mat, Plani i Bardhë dhe Qafa e Buallit, Bulqizë Mbreshtan dhe Galinë, Berat.

Gjatë këqyrjes në terren, gjenerallejtënant Kingji vlerësoi përkushtimin, profesionalizmin dhe sakrificën e efektivëve të FA-së, duke theksuar rëndësinë e reagimit të koordinuar dhe të menjëhershëm në këto situata emergjente. Megjithatë përpjekjet e FA-ve dhe strukturave vendore kanë qenë të pandalshme, vështirësitë në terren vijojnë të jenë të pranishme për shkak të kushteve atmosferike të pafavorshme, terrenit të thyer malor dhe erërave të forta, veçanërisht në zonat rurale të thella.

Forcat e Armatosura mbeten në gatishmëri të plotë dhe do të vijojnë angazhimin me të gjitha kapacitetet operacionale në funksion të sigurisë së komuniteteve të prekura dhe mbrojtjes së mjedisit natyror të vendit.



Montim i suksesshëm i urës “Bailey” në vetëm 8 ditë, përmirësohet ndërlidhja e katër fshatrave

Perlat, Laç, Bruc dhe Lufaj përfitojnë nga ndërhyrja e Batalionit të Xhenios
Brenda një afati prej vetëm 8 ditësh, kompania e urave e Batalionit të Xhenios ka përfunduar me sukses montimin e një ure të tipit “Bailey”, me gjatësi 21 metra, seksion 2/1 dhe kapacitet mbajtës deri në 44 tonë.

Projekti përfshiu të gjithë ciklin teknik dhe logjistik: nga transportimi i pajisjeve, montimi në terren, e deri te kthimi i tyre në repart, duke dëshmuar efikasitetin dhe përkushtimin e strukturave të Forcave të Armatosura.

Ura e re pritët të përmirësojë ndjeshëm qarkullimin dhe aksesin për rreth 750 banorë të fshatrave Perlat, Laç, Bruc dhe Lufaj, duke i ndërlidhur ata më lehtë me qendrat urbane dhe shërbimet bazë.

Kjo ndërhyrje përbën një tjetër shembull konkret të mbështetjes që Forcat e Armatosura japin për komunitetin, veçanërisht në zonat e thella, ku nevojat infrastrukturore janë të larta dhe ndërhyrjet e tilla kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të banorëve.



Grupet EOD të Batalionit të Xhenios përfundojnë me sukses operacionet për largimin e municioneve në Durrës dhe Lushnjë

Specialistët e Kompanisë EOD të Batalionit të Xhenios, përfunduar me sukses operacionet xheniere për vlerësimin dhe largimin e municioneve të identifikuara në territorin e bashkive Durrës dhe Lushnjë.

Në zonën pranë portit të Durrësit, një ekip specialistësh EOD, duke zbatuar të gjitha masat e sigurisë, ka kryer identifikimin dhe vlerësimin e disa bombave të aviacionit gjysmë blind-shpuese. Pas analizës teknike, municionet janë klasifikuar si të prekshe dhe janë transportuar në mënyrë të sigurt drejt ambienteve të posaçme të Batalionit të Xhenios për trajtim të mëtejshëm. Ndërkohë, një tjetër operacion është kryer në fshatin Stan, njësi administrative Karbunarë, bashkia Lushnjë, ku operatorët EOD identifikuan dhe klasifikuan municione të tipit predha artilerie dhe predha topi të kalibrave të ndryshëm. Pas vlerësimit teknik, u konstatua se municionet ishin të lëvizshme dhe u transportuan për magazinim të sigurt në ambientet e caktuara nga Forcat e Armatosura.

Pastrimi i territorit nga municionet e rrezikshme mbetet një sfidë e përditshme për efektivët e Kompanisë EOD, të cilët me profesionalizëm dhe përkushtim kontribuojnë në rritjen e sigurisë së komuniteteve dhe mjedisit.



FORCAT E *Armatosura*





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Korriku i këtij viti mbërriti i nxehtë, i paepur, me frymë të rëndë dhe stuhi flakësh që përfshinë malet, kodrat dhe shpirtin e çdo shqiptari. Nuk ishte hera e parë që vendi ynë përballlej me zjarre, por këtë herë gjithçka kishte tjetër përmasë: mbi 70 vatra aktive në të njëjtën kohë, në të gjithë vendin, nga veriu në jug, nga lugina e Gjirokastrës te kodrat e Lezhës, nga pyjet e Thethit te kodrat e Butrintit. Në këtë përballje titanike, kur çdo ditë dukej si një betejë për jetë a vdekje, ata që dolën përpara flakëve nuk ishin heronj të filmave, por bij dhe bija të këtij vendi me uniformë ushtarake, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Kur ushtari nuk ruan vetëm kufirin, por mbjell jetën

Në çdo krizë natyrore, Forcat e Armatosura nuk janë thjesht një mekanizëm mbrojtës. Ata janë simbol i përkushtimit ndaj jetës dhe njerëzve. Korriku i 2025-ës na tregoi edhe njëherë pse ky mision nuk është thjesht profesion por është betim.

Nga zjarret që përfshinë Malin e Tomorit, tek flakët në Karaburun e më tej në Dajt, ushtarakët tanë ishin të parët që u gjendën aty. Pa ankesë, pa hezitim, me mjete, me duar, me zemër.

Ata u ngjitën shpate të thepisura, hynë në terrene të pakalueshme me automjete, përdorën pompa uji në kushte ekstreme, u përballën me tym, nxehtësi përvëluese, lodhje fizike dhe kërcënim real për jetën.

Zëri i ushtarit: “S’kishim kohë të trembeshim”

Intervistat e dhëna nga vetë ushtarakët janë dëshmi të një përkushtimi që tejkalon detyrën. Njëri prej tyre, dhe zëri i të gjithëve rrëfen: “Kur arritëm aty, tymi na verboi dhe flakët ishin vetëm disa metra larg shtëpive. Fëmijët dhe të moshuarit kishin dalë në rrugë me sy të përplotur. Nuk na duhej urdhër për të hyrë në zjarr. S’kishim kohë të trembeshim. Ishim aty sepse nuk mund të mos ishim”.

Këto janë fjalë që nuk shkruhen lehtë. Janë fjalë që rrjedhin nga përvoja, nga përgjegjësia morale dhe nga një



Nën flakët e korrikut: Kur uniforma e ushtarakut u bë mburojë ndaj zjarrit

ndjenjë që shkon përtej hierarkisë ushtarake, është ndjenja e detyrimit ndaj popullit.

Mburoja e gjelbër e Shqipërisë: pyjet dhe ata që i mbrojnë

Zjarret e korrikut nuk dogjën vetëm drurë e shkurre, ato kërcënuan pasurinë më të çmuar natyrore të vendit tonë: pyjet. Shqipëria është e bekuar me një peizazh të pasur që ndikon drejtpërdrejt në klimën, biodiversitetin dhe jetën tonë të përditshme.

Kur flakët kërcënojnë pyllin, nuk digjet vetëm një pemë, digjet një zinxhir jetësor që përfshin kafshë, shpendë, insekte, burime uji dhe gjithë ekosistemin.

Falë ndërhyrjes së shpejtë dhe të organizuar të Forcave të

Armatosura, shumë prej këtyre zonave u shpëtuan. Ata nuk shuan vetëm zjarret, por mbrojtën ajrin tonë, ujin tonë, të ardhmen tonë.

Logjistika e guximit: helikopterët, pajisjet, bashkëpunimi

Ky operacion i gjerë kërkonte më shumë sesa vetëm vullnet, kërkonte organizim ushtarak, logjistikë të sofistikuar dhe bashkëpunim institucional.

Helikopterët e Forcave të Armatosura u ngritën çdo mëngjes në fluturime të rrezikshme për të bërë hedhje uji mbi vatrat kryesore. Pilotët tanë rrezikuan jetën duke fluturuar në kushte të vështira ajrore, mbi male të përflakura, mes tymit të dendur. Në bashkëpunim me Emergjencat Civile, strukturat vendore, zjarrfikësit dhe vullnetarët, Forcat e Armatosura u bënë shtylla që mbajti në këmbë gjithë operacionin e përbashkët. Ky ishte modeli i një shteti në veprim, me ushtrinë në ballë.

Kur uniforma nuk mban vetëm armë, por shpresë

Pamjet që qarkulluan në mediat vendase dhe ndërkombëtare ishin tronditëse: një ushtar i lodhur, me fytyrë të nxirë nga tymi, mbante në krah një të moshuar që po evakuohej. Një tjetër ndihmonte një djalosh të vogël të nxirrte nga shtëpia një qen të trembur. Uniforma e ushtarakëve tanë nuk mban vetëm armë. Ajo mban shpresë. Në ato ditë të nxehta, ku flakët dukeshin të pandalshme, prania e një ushtari ishte më e fortë se çdo premtim politik apo deklaratë publike. Ishte siguria që shteti ishte aty. Ishte prova se Shqipëria nuk e braktis popullin e saj.

Një falënderim që nuk mjafton kurrë

Ky material, nuk mund të përmbledhë gjithë sakrificën e ushtarakëve tanë gjatë këtyre ditëve përvëluese korriku; nuk mund të përshkruajë plotësisht lodhjen, rrezikun dhe përkushtimin që ata treguan. Por ajo që mund të bëjmë si qytetarë, si media dhe si institucione, është të mos i harrojmë.

Le të jetë kjo një thirrje për mirënjohje dhe një dëshmi se Shqipëria, në ditët e saj më të vështira, ka një mbrojtje të çmuar: bijtë dhe bijat e saj me uniformë.

Faleminderit Forcave të Armatosura! Në korrikun e zjarrtë, ju ishit freskia e ndërgjegjes sonë!



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në kuadrin e përvjetorit të 25-të të rënies së Dëshmorit të Atdheut, oficerit të Policisë së Shtetit Arben Shuaip Zylyftarit, i shpallur me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut”, me Vendim nr.16 datë 3.8.2000, të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe i nderuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Urdhërin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”. Nderim, mirënjohje përjetë për bijtë e Policisë së Shtetit që e mbrojtën jetën me jetë.

Kolonel Arben Zylyftari ka qenë drejtor i Policisë së Shtetit për qarkun e Shkodrës. Një çerek shekulli më parë, më 2 gusht të vitit 2000, dha jetën në mbrojtje të rendit dhe sigurisë publike shqiptare. Arben Zylyftari me veprën e tij shkroi pavdekësinë në librin e artë të Policisë së Shtetit dhe ngeli frymëzim për brezat e rinj, prandaj edhe nderohet dhe respektohet nga organizata e Policisë së Shtetit dhe mbarë shoqëria. Vlerësimet e shumta në 25 vite e bëjnë dëshmorin Arben Zylyftari të paharruar përjetësisht, pasi koloneli i policisë shqiptare u vra në krye të detyrës në emër të një ideali të madh për rend dhe siguri publike në Shqipëri.

Arben Zylyftari dhe qindra dëshmorë të tjerë të Policisë së Shtetit sakrifkuan jetën për vlera e parime, për drejtësi, rend e siguri për qytetarët. Krimi dhe dora e pabesë e errësirës që ngrihet mbi Policinë që kërkon të sfidojë shtetin, ligjin e drejtësinë meriton dënimin e ndëshkimit më të rëndë, prandaj edhe shqiptarët janë sot gjithë sy e veshë nga drejtësia e re. Gjithë organizata e punonjësve të Policisë së Shtetit, ka shembuj të guximshëm e frymëzues që Shqipëria të jetë më e sigurt dhe një vend më i drejtë. Policia e Shtetit përballet me sfida të reja dhe komplekse, por sfidat ndriçojnë rrugën që duhet të ndjekë punonjësi i policisë, duke shprehur respekt e mirënjohje të thellë për të rënë të policisë, pasi ata nuk derdhën vetëm gjakun e tyre në mbrojtje të jetës së qytetarëve, por dhe vetë gjakun e shtetit. Policia punon për të qenë më solide se kurrë dhe e vendosur se nuk do të reshtë asnjëherë për të vënë para drejtësisë shkelësit e ligjit, krimin e kriminalitetin si dhe për ta bërë Policinë edhe më solide në përballje me krimin.

Zylyftarajt – porta dhe oxhaku i atdhetarisë dhe fisnikërisë beratase

Zylyftarajt janë një oxhak i madh, një vatër atdhetarie dhe portë e fisnikërisë beratase. Është një fis me rrënjë që ofron mirësi brezash, por edhe krenari kombëtare. Rrënjët e fisit Zylyftari shtrihen thellë në histori në fshatin Spathar të Skraparit. Shuaip dhe Refije Zylyftari kishin dhe kanë tetë fëmijë, shtatë djem dhe një vajzë. Janë një familje e madhe, një familje e madhe dhe e njohur, që në gjirin e tyre kanë një dëshmor të rënë për Atdheun, në mbrojtje të ligjit, rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri. Ata ishin dhe janë gjithmonë bashkë: motra Serma, e datëlindjes 1944 dhe vëllezërit Vullneti i datëlindjes 1948, Petriti i datëlindjes 1951, Agimi i datëlindjes 1953, Vladimiri i datëlindjes 1955, Edmondi i datëlindjes 1958, Arbeni i datëlindjes 1963 dhe i fundit Roberti i datëlindjes 1965. Djalin e parafundit të familjes e kanë tashmë në memorial, në nderimin, respektin dhe mirënjohjen e gjithë Policisë së Shtetit, të institucioneve të gjithë shoqërisë shqiptare. Zylyftarajt e Beratit janë shembulli i lartë qytetarisë, fisnikërisë dhe dashurisë vëllazërore. Miq, shokë, kolegë të flasin për familjen e Shuaip Zylyftarit, burrin e shtruar të urtë, të nderuar dhe inteligjent, që i përkiste fisnikërisë beratase, sepse kishte lindur, rritur dhe edukuar, bashkë me bashkëshorten Refijen tetë fëmijë, që edhe pse ishte heroinë e fëmijëve të vet nuk pëlqente vlerësime e merita, por veç për sakrifica dhe përkushtim. Është nga ato familje që ka qenë dhe ka ngelur familje me nder e oxhak, sepse rrënjët e atdhetarisë dhe të dashurisë për kombin edukohen në shkollë, por mbi të gjitha në familje e shoqëri. Fëmijët e Zylyftarajve, por edhe nipa e mbesa që kanë ardhur në jetë edhe në këtë çerekshekulli të mungesës fizike të Arbenit janë që të gjithë nder e krenari beratase, sikurse mësuesja Serma Zylyftari/Muhadri; Vullnet Zylyftari, ikonë e mirësisë e drejtimit dhe organizimit në shumë institucione, por dhe ish-alpinist i Beratit bashkë me vëllain alpinist, Agim Zylyftari e kishin bërë Malin e Tomyrit si shtëpinë e tyre të dytë; Petrit Zylyftari inxhinieri i talentuar, që shokët e quajnë ‘djalë flori’; por kështu kanë qenë dhe kanë ngelur gjithë bijtë e Shuaipit, të rritur, të burrëruar, baballarë e gjyshër, familja e fisnikëruar. Kështu janë nga kjo portë e madhe e Zylyftarajve: Agimi ekonomist, biri tjetër Vladimir, doktor Edmondi, Roberti më i vogli i djemve. Kjo vatër atdhetare, ky oxhak dhe kjo portë beratase ka një tjetër djalë, tashmë të burrëruar dhe të trupëzuar me valët e flamurit kombëtar, një bir të denjë të Beratit dhe Shqipërisë, një komisar të hekurt të luftës me krimin në Shqipëri, një ikonë të çmuar të shqiptarizms, kolonel Arben Zylyftari, i cili ra në krye të detyrës në Shkodër, për të mos vdekur e për të mos u harruar kurrë, për të jetuar përjetësisht në radhët e Policisë së Shtetit, që bashkoi gjakun e tij me gjakun e gjithë policëve dhe oficerëve të policisë që gjakun e tyre e vendosën në themel të fuqizimit të shtetit të së drejtës. Kolonel A. Zylyftari prehet në Varrezat e Dëshmorëve të Beratit që ndodhen buzë rrugës,



pranë bulevardit kryesor në lagjen e njohur nga qytetarët beratas, “Murat Çelepisë”, pranë Urës së Goricës. Banesa ku lindi Arben Zylyftari, ku hodhi hapat e parë, ku buzëqeshi dhe belbëzoi për herë të parë, ku thirri emrin baba, nënë, motër, vëlla për herë të parë, është pranë banesës së përjetshme në varrezat e nderit, me Varrezat e Dëshmorëve, aty ku yjet ngelen përherë të pashuar dhe nderimi është i përjetshëm, atje në qytetin mijëvjeçar të Beratit të civilizimeve, të lashtësisë dhe të historisë. Është oxhaku dhe porta e madhe e familjes Zylyftari në Berat, një familje shembull civilizimi e kulturës qytetare, por dhe e rrezatimit të dashurisë e unitetit të vlerave vëllazërore.

Dëshmorët e Atdheut përjetësohen vetëm në këngë, një traditë e moçme shqiptare

Të rënë të kombit shqiptar janë të shumtë në të gjitha epokat. Edhe policia ka qindra dëshmorë nga radhët e saj, deri në nivelet më të larta të gradave. Arben Zylyftari ishte një ndër djemtë e Policisë së Shtetit që u përball me krimin dhe punoi për zhdukjen e tij në Shqipëri. Ai dha jetën për një ideal madhor të sigurisë së shtetit. Kështu ka qenë e mërkura e datës 2 gusht të vitit 2000, kur kolonel Arben Zylyftari drejtonte një operacion kundër kriminelëve, që kishin marrë shumë jetë njerëzish. Fakt është se ishte operacion tepër i vështirë. Por, për fat të keq, mes radhëve të policisë gjenden dhe bashkëpunëtorë të njerëzve të krimit, të cilët bënë që plumbat e parë të përshkonin trupin e tij. Për prindërit e Arben Zylyftarit, 37 vjeçarit, 2 gusht i vitit 2000, ishte e

“mërkura e zezë”. Nëna e Arbenit, Refija, bijë nga Zhepova e Përmetit, nuk mundi t’i bënte ball dhimbjes, por bashkëshorti i saj, Shuaipi, i mençur dhe i qetë, por me dhimbje të thellë në shpirt i flet bashkëshortes ashpër: “Kemi plot fëmijë të tjerë. Nuk është i pari djalë ynë që bie për një Shqipëri më të mirë”. Por lotët rridhnin vilarë dhe zemrat e prindërve të mirë u plagosën rëndë në pleqëri. Në atë kohë e shoqja e Arbenit, Elsa, mësuesja e talentuar e letërsisë, një grua e përsosur, veshi rrobat e zeza në moshë fare të re, duke fshirë lotët para fëmijëve të saj të vegjël, Enit 8-vjeçar dhe Francit 4-vjeçar. Ata tashmë janë rritur dhe janë bijtë e dëshmorit, janë të mirë edukuar, njerëz të vlefshëm për shoqërinë, sikurse babai i tyre. Humbja e kolonelit ishte dhimbje mbarëshqiptare në Shkodër, ku ndodhi ngjarja, në Berat, në Vlorë, Kolonjë, Skrapar e Përmet, kudo që kishte punuar apo mbante lidhje miqësore e shoqërore. Duke hulumtuar në shpirtin shqiptar, për të parë vargëzimin në vargje dhe në këngë, për Dëshmorin e Atdheut Arben Zylyftari me rastin e njëzet e pesë vjetorit të rënies në krye të detyrës, mes të tjerash gjejmë edhe këngë e vargje poetike. Kënga dhe vargëzimi poetik, në poezi dhe prozë nuk ka munguar dhe nuk mungon asnjëherë për trimat, për të rënë, për dëshmorët e Shqipërisë. Ka qenë, është dhe do të ngelet brez pas brezi kënga e nderimi për dëshmorët. Ata kanë rënë në periudha të ndryshme të historisë, por kanë një gjë të përbashkët, gjakun e derdhur për atdheun dhe ngelen sigurisht në këngë dhe në përjetësi. Ja vargjet poetike dhe vaji përsëri që është një këngë për dëshmorin Arben Zylyftari:

*“Atë ditë dy Gushti/Qielli krejt u nxi/Shkodra, Shqipëria/U
gdhinë në zi/
Lajmi mori dhenë/Derdhi lot Skrapari /Kishte rënë një lis/
Arben Zylyftari/
Njëzet vjet më parë/Atë dy gusht të zi/Buna dhe Osumi/Lotët
derdhën shi/
Njëzet vjet më parë/Shkodra qau me lot/Lotët mbarë
Shqipëria/Nuk i mbajti dot/
Asaj dore barbare/Gishti si s’ju këput/Kur lisin – Arben,/ E
shtriu në tabut?!!
Pabesia e krimit/Një gjarpër në gji/ I këputi rrënjët/Një lisi
të ri/
Atij djali – lis/Me rrënjë në Spatharë/Këngë i thurrën gurrët/
Malet në Skrapar/
Plumbi i mallkuar/S’vrau një kolonel/Ai shoi një dritë/Ai
rrëzoi një diell/
Arben Zylyftari/Lisi që s’ka rënë/Ai është me këmbë/Me degë
e me rrënjë/
Tani pas kaq vitesh/Drita është e bardhë/”Dardha” që la
Beni/ Ka rënë nën dardhë/
Fëmijët si yje/Ndrijnë e yllëzojnë/Në çdo hap që hedhin/Me
Benin jetojnë/
Filizat u rritën/Lisi u ngrit më këmbë/Arben Zylyftari/
Asnjëherë s’ka rënë/
Në mes të Beratit/Përmendorja ndrin/Se heronjtë e heshtur/
Përherë zgjuar rrinë/
Në bronxin e ftohtë/Qendron vigjilent/E desh’ shumë Beratin/
Shumë e desh’ këtë vend/
Arben Zylyftari/Syri i Shqiponjës/Gjithmonë syshqiponjë/Do
t’i qendrojë kohës.*

Vargëzimi poetik mban brenda një peshë të fuqishme të dhimbjes së 2 Gushtit, për vendlindjen - Beratën, për Shkodrën, ku kolonel Arbeni shërbeu me energji djaloshare si misionar i ligjit dhe shtetit si dhe për mbarë Shqipërinë, që e qau dëshmorin 37-vjeçar si birin e vet, si misionarin e rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri.

Arma e ngritur kundër Policisë së Shtetit është krim i ndëshkueshëm rëndë

Historia ka folur dhe do të flasë për heronjtë e saj. Ngjarja, sipas prokurorisë shqiptare, flet për: “...2 gusht 2000, rreth orës 14.30 forcat e policisë së Shkodrës nën drejtimin e shefit të policisë kriminale, dëshmitarit V.A., me katër grupe të gatshme, së bashku me komandantin e grupeve të gatshme, dëshmitarin P.P., janë nisur në drejtim të lagjes “Ahmet Haxhia” në Shkodër. Janë futur në rrugën me drejtim Udhakryq-Livadhe për patrullim me objekt kryesor për verifikim të parkingjeve, nëse ka ose jo automjete të vjedhura, pasi mbi bazën e informacioneve mjetet e vjedhura mund të ishin strehuar në këtë lagje, pasi njihej nga policia si zonë me probleme të tilla. Kur mjetet e policisë kanë hyrë në rrugicën që të çon tek shtëpia e të pandehurit T.G., kanë vënë re një burrë të moshuar që është larguar me vrap, pasi ka parë makinat e policisë. Një nga agjentët e policisë kriminale, i paidentifikuar nga hetimi, ka thënë: “Ky personi që u largua me vrap është në kërkim për vrasje. Janë thirrur forcat dhe policia ka qëndruar para shtëpisë ku kishte hyrë personi që iku”. Dëshmitari P.P., i ka thënë shefit të krimeve se personi i larguar me vrap është i kërkuar për vrasje. U vendos të hyhej dhe policia ka hyrë nga muret rrethuese brenda shtëpisë. Policia ka vënë re se personi i larguar dhe një person i ri, rreth moshës 25 vjeç, morën diçka në dyshemenë e korridorit që dukeshin si armë kallashnikov dhe hynë në një dhomë që dukej përballë me një derë dhe u ngjitën lart në tarracën e shtëpisë. Tek dera ka dalë një grua me dy nuse dhe ka thënë se “nuk ka njeri tjetër në shtëpi dhe se dy persona kundrejt pagesës e ruajnë shtëpinë për shkak se jemi në gjak”, ndërkohë që burri ndodhej në Greqi. Vendoset të bëhet hyrja në shtëpi. Në fundin e korridorit ishte një banjo e ndarë në dy pjesë, ku njëra ishte me dalje në tarracë me shkallë hekuri. Është urdhëruar njëri prej policëve që të ngjitej në tarracë dhe polici sapo ka hipur lart dhe ka çuar me dorë kapakun e tarracës, dikush nga lart ka hapur zjarr me breshëri, duke thënë, “mos hipni lart se do t’ju vras”. Në këto rrethana, duke parë që situata u rëndua dhe policia nuk duhej të tërhiqej, shefi i krimeve ka urdhëruar që shtëpia të mbahej në rrethim duke qëndruar vetë në banesë dhe gjithashtu ka komunikuar në radio me drejtorin, Arben Zylyftarin, duke i kërkuar të sillte forcat speciale. Dy personat e armatosur kanë kaluar nëpër tarracat e shtëpive dhe janë vendosur në një kasolle kali, pronë e dëshmitarit L.Sh. Gjatë gjithë kësaj kohe të lëvizjes nuk ka patur asnjë shkëmbim zjarri. T.B. dhe i pandehuri T.G., janë pozicionuar me armë në penxheren e kasolles së kalit me mendimin për t’i shpëtuar rrethimit të policisë. Gjatë veprimeve të të dy të armatosurve, pjesëtarët e tjerë të familjes kanë qenë të grumbulluar në një dhomë në shtëpi nën mbikëqyrjen e policisë. Ndërkohë në vendin e ngjarjes ka mbërritur drejtori A. Zylyftari. Drejtori ka zbritur nga makina bashkë me shoferin dhe shoqëruesin e tij, në një largësi prej 100 metrash, duke kontrolluar rrethimin e policisë. Sipër tarracës së kasolles së kalit kishin hipur me zvarritje disa policë të armatosur dhe të maskuar. Në deklaratimet e të pandehurit është thënë se bashkë me të atin kishin kuptuar se sipër tarracës kishte njerëz. Në një kohë me A. Zylyftarin ka shkuar në vendin e ngjarjes edhe shefi i rendit, dëshmitari A.A. Me drejtorin në vendngjarje është takuar edhe shefi i FNSH-së Gj.Gj. Policia iu ka bërë thirrje të rrethuarve të dorëzoheshin, por nuk është marrë asnjë përgjigje prej tyre. Ndërkohë drejtori me shoferin dhe shoqëruesin e tij kanë lëvizur në këmbë për nga perëndimore, rreth 20 metër larg kasolles së kalit. Që nga kjo pikë janë vënë re policë me maska të shtrirë barkas mbi tarracën e kasolles së kalit në pozicion luftimi. Në atë kohë Arben Zylyftari ka komunikuar në celular me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, dhe pikërisht në atë moment u dëgjua një e shtënë e vetme arme dhe të gjithë forcat e policisë kanë rënë në pozicion barkas. Në atë moment dëshmitari E.P., që ka qenë në krah të majtë të drejtorit,



ka dëgjuar A. Zylyftarin që tha: “Oh, më vranë”. Kur ka rënë në tokë, drejtori ka hequr celularin dhe i ka thënë E. që të lidhej me Ministrinë e Brendshme, për të nisur urgjentisht një helikopter për t’i dhënë ndihmën e shpejtë. Duke qenë në pozicion barkas dhe duke u përpjekur për t’i dhënë ndihmën drejtorit, është qëlluar me breshëri automatiku nga dritarja e kasolles së kalit në drejtim të policëve që ishin në afërsi të drejtorit. Në këto rrethana është vënë re vendi nga qëllonin të rrethuarit. Punonjësit e policisë nuk kishin mundësi të qëllonin pasi mbi kasolle ishin forcat e policisë, që iu bënëin thirrje të dyshuarve të dilnin nga kasollja. Ndërkohë që bashkëpunëtorët e drejtorit, po përpiqeshin të fushnin të plagosurin në mikrobus është hapur zjarr nga kasollja mbi mjet duke e nxjerrë jashtë përdorimit. Është afruar mikrobusi i dytë dhe si rezultat i mbulimit me zjarr nga policët e tjerë, është arritur të futet trupi i drejtorit nga dera e prapme në mjet, pasi dera e pasagjerit ka qenë përballë dritares së kasolles nga ku hapej zjarr. Koha, nga momenti i plagosjes deri në momentin e largimit të mikrobusit, ka qenë 7-9 minuta. Në spital, në sallën e operacionit, drejtori i policisë Arben Zylyftari ka ndërruar jetë, më 2.8.2000, në qytetin e Shkodrës, në kohën që kryente funksionin e Drejtorit të Policisë së Qarkut, duke lënë pas emrin e mirë si dhe karrierën e shpejtë. Arben Zylyftari ishte diplomuar më 1989 në Akademinë e Rendit në Sauk, ishte emëruar Oficer i Policisë në Korçë; 4 muaj më vonë ngrihet në detyrë dhe emërohet zëvendës shef i policisë për ndjekjen e krimeve. Më 1991 emërohet Shef i Sektorit të Ndjekjes së Krimeve për rrethin e Korçës. Më 3 gusht 1993 lirohet nga kjo detyrë si dhe në fund të korrikut 1997, Arben Zylyftari emërohet drejtor i Drejtorisë së Policisë për Prefekturën e Korçës. Pas kësaj detyre mori detyra në policinë e Vlorës, Lezhës e Shkodrës, ndërkohë që vritet më 2 gusht 2000, gjatë kohës që ishte Drejtori i Policisë së Qarkut të Shkodrës. Sidoqoftë dora kriminale që ngrihet kundër përfaqësuesit të Policisë së Shtetit është krim absolut i ndëshkueshëm dhe i dënueshëm.

Shtetarët që nderuan birin e Beratit dhe gjithë Shqipërisë
Dëshmorët janë zemra e historisë...! Kur flasim për dëshmorët, nuk ka shqiptar që nuk përulet, por edhe që syri loton e kërkon bijtë që i bëjnë nder kombit, bijtë që kanë rënë në fushën e nderit, në betejat luftarake, edhe pse beteja me krimin është dhe mbetet një betejë e përgjakshme. Prandaj edhe gjaku i policisë është gjak i vetë shtetit. Një angazhim serioz i gjithëkohshëm dhe detyrim moral i çdo brezi. Nderi, respekti dhe mirënjohja e kanë një bazë solide tek shteti i së drejtës dhe tek e drejta e mbijetesës së brezave. Ndërkohë që dora e zezë kriminale shkaktoi plagë të thella në zemrat e familjarëve, në zemrat e mbarë qytetarëve beratas, në familjarët e Portës së madhe të Zylyftarajve, duke fashitur gëzimet familjare në shtëpinë e tyre ku u lindën dhe u rritën, sepse mungon fizikisht biri, vëllai, bashkëshorti, babai i dy fëmijëve që la pas, dëshmori Arben Zylyftari. Në sytë e fëmijëve është e ardhmja e trashëguar nga prindërit, civilizimi, qytetaria dhe kultura, harmonia dhe respekti. Një portë e madhe gjithmonë e hapur, një vlerë qytetare beratase, si amanet i dy prindërve për brezat, bërë bijtë e bijat, për nipat e mbesat. Presidenti i Republikës i ka bërë këtë dedikim dëshmorit të Atdheut Kolonel Arben Zylyftarit: “Nderojmë me vlerësim, mirënjohje e respekt të thellë kujtimin, veprën dhe sakrificën sublime të Dëshmorit të Atdheut, Kolonel Arben Zylyftarit, i cili ra në krye të detyrës njëzet vite më parë në luftë me krimin. Dita e sotme na risjell në vëmendje qindra Dëshmorë të Policisë së Shtetit, që të udhëhequr nga ndershmëria, përkushtimi dhe përgjegjësia e lartë qytetare e shtetërore, sakrifikuan jetën e tyre për mbrojtjen e rendit, qetësisë e sigurisë publike, por edhe të vlerave e parimeve që duhet të udhëheqin cilindo që mban veshur uniformën e shtetit. Është me

rëndësi jetike që Policia e Shtetit të jetë shembulli i respektimit të ligjit për t’u shërbyer me nder, përkushtim e dinjitet qytetarëve, duke u distancuar nga lidhjet me krimin, politikën dhe praktikat arbitrare... Gjaku i Dëshmorëve të Atdheut, nuk do të bëhet ujë dhe mbarë populli shqiptar do t’i kujtojë përherë me krenari e respekt Heronjtë e tij”.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Drejtoria Vendore e Policisë Berat, në përvjetorët e rënies në krye të detyrës së ish-zyrtarit të lartë të Policisë Arben Zylyftari, kanë zhvilluar një ceremoni përkujtimore në nderim dhe mirënjohje të veprës së tij. Në mënyrë të herëpashershme janë zhvilluar ceremoni pranë bustit të Arben Zylyftarit, me pjesëmarrje nga drejtuesit më të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prefektura e Qarkut, Këshillit të Qarkut, Kryetari i Bashkisë së Beratit, familjarët e Dëshmorit të Policisë, Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, punonjës policie të DVP Berat, miq e të afërm. Konsideratat më të larta të drejtuesve të policisë në vite kanë të regjistruar se, “të nderosh veprën dhe të kujtosh ata që sakrifkuan gjënë më të shtrenjtë, jetën, për të përmbushur me nder detyrën, për t’i shërbyer me dinjitet vendit, nuk është detyrë e radhës, por është obligim e detyrim moral për të gjithë ne, për të gjithë shoqërinë, ndaj dhe jemi sot këtu për të kujtuar e nderuar veprën dhe sakrificën e kolegut, mikut, shokut e familjarit Arben Zylyftari. Ata kanë vlerësuar si ditë kujtese e vlerësimi, ditë apeli dhe reflektimi, ditë për të risjellë në vëmendjen e të gjithëve vlerat dhe sakrificën sublime të qindra Dëshmorëve të Policisë së Shtetit... Zakoni e do që të thuhet fjalë të mira për atë që ikën nga kjo botë, por Arbeni e kishte shkruar vetë respektin, mirënjohjen dhe dinjitetin në çdo ditë të detyrës së tij, me peshën e misionit që mbante mbi supe. Dora kriminale vrau në krye të detyrës, një nga oficerët dhe drejtuesit më shembullorë të Policisë së Shtetit, i cili nuk zgjodhi të komandonte nga zyra, por i udhëhequr nga ndershmëria, përkushtimi, përgjegjësia, drejtoi operacionin policor për kapjen e një autori me veprimtari të rrezikshme kriminale dhe fatkeqësisht, gjatë kryerjes së operacionit, dora kriminale i mori jetën Arbenit. Arben Zylyftari dhe qindra dëshmorë të Policisë sakrifkuan jetën për vlera dhe parime, për drejtësi, rend e siguri për qytetarët, por fatëkeqësisht këto dekada, dora e pabesë... përpiqet të sfidojë shtetin, ligjin e drejtësinë dhe drejtësinë e vjetër rrallë u ka dhënë dënimin e merituar. Të gjithë sot jemi me sytë nga drejtësia e re... Përtej dhimbjes e mallit për mungesën njëzetvjeçare, përtej lotëve, Ju duhet të ndiheni krenarë për veprën dhe sakrificën e njeriut tuaj të dashur e të shtrenjtë, por jo vetëm ju, krenarë ndihemi të gjithë ne, pjesëtarët e organizatës së Policisë e do ndihen të gjithë brezat që do të vijnë. Arben Zylyftarit dhe të gjithë Dëshmorëve të Policisë u jemi mirënjohës për sakrificën dhe iu detyrohem i vazhdojmë dhe të përmbushim misionin tonë, sa fisnik aq edhe të vështirë, luftën pa kompromis ndaj krimit të organizuar, sigurimin e rendit e qetësisë dhe për t’i shërbyer me nder, përkushtim e dinjitet qytetarëve... Sfidat nuk na dobësojnë, por na ndriçojnë rrugën që duhet të ndjekim...”. Kështu është përkujtuar dhe do të përkujtohet në përjetësi Koloneli i Policisë Arben Zylyftari.


Nga takimi përpara disa vitesh, vëllai i dëshmorit Vullnet Zylyftari do shprehej: “Edhe pse kanë kaluar njëzet e pesë vite, kur dora kriminale gjakatave shkrepri armën vrastare ndaj Kolonel Arben Zylyftarit, nuk dua ta besoj që Beni ynë, miku, shoku, bashkqytetari ynë nuk jeton më! Arben Zylyftari vëlla, bashkëqytetar, azgan, flori djalë, me virtytet më të larta njerëzore, me kulturë të lartë qytetare, ashtu siç janë të 8-të fëmijët, 7-të vëllezërit dhe motra e tyre e vetme, e prindërve shembullorë, të ndjerët Refije dhe Shuaip Zylyftari, shembull dhe krenari për Beratin dhe më gjerë... Arben Zylyftari, koloneli energjik dhe i suksesshëm në detyrat e kryera në Korçë, Vlorë, Skrapar, Lezhë, Shkodër, ku edhe iu pre jeta në mes, në atë qytet në kulmin e moshës, të karrierës, të sukseseve të tij në fundvitet 90-të, la një plagë të madhe tek të gjithë ata që patën fatin e madh ta njihnin, të punonin me të, të shikonin dhe të jetonin sukseset e tij ndaj kriminelëve dhe bandave kriminale që ishin përhapur në atë kohë pothuajse në të gjithë Shqipërinë. Unë personalisht, familja ime, qytetarët e Beratit, qytetarët e gjithë qyteteve ku punoi me vetëmohim dhe përkushtim, nuk do ta harrojnë kurrë kolonelin e suksesshëm... Prehu i qetë në parajsën e përjetshme i dashur vëlla, shok, mik, bashkëqytetar i paharruar, Arben Zylyftari”.

Vlerësime dhe nderime për kolonelin e hekurt, Arben Zylyftari

Kolonel Zylyftari ka lënë një emër të mirë. Ai ka qenë anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Shefave të Policisë. Bashkia e Beratit, qyteti ku u lind dhe u rrit e ka nderuar me titullin e lartë: “Qytetar Nderi” dhe busti i dëshmorit Kolonel Arben Zylyftarit është vendosur në lulishten qendrore të Beratit dhe në ambientet e Akademisë së Sigurisë në Sauk të Tiranës. Dëshmori i Atdheut Arben Zylyftari pas vdekjes, është vlerësuar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, zoti Rexhep Meidani, me Urdhërin “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”. Ndërsa me Vendim nr.16 datë 3.8.2000, të Komisionit Qendror të Statusit “Dëshmor i Atdheut”, pranë Ministrisë së Mbrojtjes është shpallur me titullin më të lartë për të rënë të është “Dëshmor i Atdheut”.

Burimet e studimit: Sipas të dhënave të marra nga DPPSH, Libri Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi, Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, “Dëshmorët e Atdheut”, Botim i Ministrisë së Mbrojtjes me rastin e 100-vjetorit të Shtetit Shqiptar, Tiranë, Shtypshkronja “Real-Stamp”–Dëshmorët e Atdheut të Beratit, pas vitit 1945, nr. 6-të, faqe 21, Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi, In memoriam Arben Zylyftari/oxhaku dhe porta e madhe e familjes Zylyftari në Berat, 3.8.2020 (në kuadrin e 20-vjetorit të rënies në krye të detyrës; https://alb-spirit.com/2020/08/03/in-memoriam-arben-zylyftarioxhaku-dhe-porta-e-madhe-e-familjes-zylyftari-ne-berat/, të dhëna të marra nga familjarët e dëshmorit të Atdheut Arben Zylyftari, Zaho Golemi, Gjaku i Policisë është gjaku i shtetit, Tiranë, 2021, Fatmira Mustafaj, Gazeta “Telegraf”, Në 24-vjetorin e rënies së dëshmorit Arben Zylyftari, 1 gusht 2024.

GJUHA JONE, UNIFORMA E PADUKSHME E ÇDO SHQIPTARI



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Mbrojtja e gjuhës, detyrë kombëtare si çdo mision ushtarak

Në diskursin bashkëkohor të gjeopolitikës, gjuha nuk është vetëm mjet komunikimi, por një armë e butë me ndikim të thellë në ndërtimin e identitetit, fuqisë dhe sovranitetit të shteteve. Ajo shërben si themel për strukturat e brendshme të shtetit dhe si faktor ndikues në arenën ndërkombëtare. Si e tillë, gjuha merr një rol të shumëfishtë: identitar, integrues, hegjemonik dhe shpeshherë strategjik.

Gjuha si bërthamë e identitetit kombëtar dhe si bazë e shtetformimit

Një gjuhë e përbashkët është elementi më i rëndësishëm për ndërtimin e kombit, pasi krijon një ndjenjë përkatësie dhe bashkimi midis individëve brenda një territori të përbashkët. Siç theksohet në analizat e shumta të gjeopolitikës së gjuhëve, për një popull, humbja e gjuhës është baras me humbjen e shpirtit dhe të dallimit si entitet politik e kulturor.

Në këtë kontekst, shqipja përbën boshtin kryesor të identitetit shqiptar.

Gjuha si mjet pushteti: Nga Babeli tek Bismarku

Shembuj historikë si miti i Kullës së Babelit apo deklarata e kancelarit Otto von Bismarck se “Amerika e Veriut flet anglisht”, tregojnë qartë se gjuha është instrument i pushtetit. Ai që kontrollon një gjuhë, kontrollon mendimin, komunikimin dhe në fund edhe politikën.

Gjuha, komanda që bashkon një komb

Në një botë të polarizuar nga gjuhët globale si anglishtja dhe frëngjishtja, shqipja mbetet një gjuhë kombëtare me shtrirje të kufizuar, por me rëndësi jetike për shqiptarët. Statusi i saj në arsim, në administratë dhe në mediat publike është i pazëvendësueshëm për ruajtjen e identitetit kombëtar. Por, përballë tryfnisë së anglishtes, që po bëhet gjithnjë e më shumë gjuha e teknologjisë, dijes dhe diplomacisë, shqipja ka nevojë për politika aktive ruajtjeje dhe zhvillimi.

Dygjuhësia dhe sfidat e politikës gjuhësore në Shqipëri

Pas viteve 1990, anglishtja ka marrë rolin dominues në sistemin arsimor dhe në komunikimin ndërkombëtar të shqiptarëve. Kjo nuk duhet parë si kërcënim për shqipen, por si nevojë për të kuptuar se ruajtja e gjuhës kombëtare nuk përjashton zotërimin e gjuhëve të tjera. Përkundrazi, një politikë gjuhësore e balancuar duhet të synojë zhvillimin e dygjuhësisë së kultivuar: ruajtjen e shqipes si gjuhë e identitetit dhe e pushtetit të brendshëm, dhe zotërimin e gjuhëve të huaja si mjete integrimi ndërkombëtar.

Gjuha si strategji kombëtare

Gjuha është shumë më tepër se një instrument komunikimi. Ajo është një aset strategjik që ndikon në politikat e brendshme dhe të jashtme të një shteti. Politika gjuhësore është në thelb politikë e sigurisë kombëtare, e ndërtimit të kohezionit shoqëror dhe e mbrojtjes së sovranitetit kulturor. Shqipja, si një gjuhë me trashëgimi të lashtë dhe funksion jetik për shqiptarët kudo që jetojnë, duhet të trajtohet si përparësi kombëtare.

Nga fronti në klasë, nga arma në zyrë: rrëfimi i grave që deshën të qëndronin ushtarë

Në përfundim të Luftës Nacionalçlirimtare, vendi ynë u përball me transformime të thella politike, shoqërore dhe ushtarake. Në këtë realitet të ri, një grup vajzash dhe grash që kishin kontribuar ndjeshëm në luftë, në radhët e Brigadave partizane dhe strukturave drejtuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u përpoqën të vazhdonin rrugën e tyre në uniformë, tashmë në një ushtri të rregullt e paqësore. Megjithatë, rruga e tyre nuk do të ishte e lehtë.

Referuar dokumenteve të Arkivit Qendror të Ushtrisë dhe dëshmime të kohës, duket qartë se pavarësisht përvojës së fituar gjatë luftës, vullnetit për të kontribuar më tej në mbrojtjen e vendit, si dhe aftësive të provuara në front, shumë prej këtyre grave nuk gjetën hapësirën e merituar në ushtrinë e pasluftës. Në nëntor të vitit 1944, përmes fonogramit Nr. 63, datë 13.11.1944, Koçi Xoxe, në cilësinë e Sekretarit Organizativ të Partisë Komuniste të Shqipërisë, urdhëronte që gratë të largoheshin gradualisht nga radhët e ushtrisë, me justifikimin se do të kontribuonin më shumë në sektorë të tjerë të jetës civile dhe se ushtria kërkonte sakrifica të mëdha.

Në këtë kontekst, roli i grave oficere u zvogëluar ndjeshëm dhe numri i tyre mbeti simbolik. Megjithatë, përpjekjet për t'i përfshirë gratë në trajnimet ushtarake nuk munguan.

Kursi i parë për oficere nisi më 28 mars 1945, në ditën e parë të themelimit të Shkollës Ushtarake "Skënderbej", ku morën pjesë 9 vajza nga radhët e brigadave partizane, ndër të cilat Valentina Murzaku, Xhevrrije Golemi dhe Katerina Priifti. Vetëm 6 prej tyre përfunduan shkollimin dhe u titulluan oficere aktive. Por ndonëse të diplomuara, shumica nuk vijuan karrierën ushtarake, një pjesë u sistemuan në institucione civile, si gazetari, administratë apo edukim.

Valentina Murzaku, një nga oficeret e para, rrëfen në kujtimet e saj se urdhri për largimin e femrave nga ushtria iu komunikua personalisht nga përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.

Ajo, bashkë me koleget, u zhvendos nga struktura ushtarake drejt sektorëve civilë: arkiva, gazeta, bankë, institucionet shkencore, duke lënë pas një ëndërr të ndërprerë për një karrierë të plotë ushtarake.

Një tjetër valë përgatitjeje për oficere ndodhi në vitet 1949–1951, me një kurs të dytë të zhvilluar në Tiranë, nga Ministria e Mbrojtjes. Rreth 10 vajza të tjera, pjesëmarrëse në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, u trajnuan dhe për disa kohë punuan në Ministrinë e Mbrojtjes, Shkollën "Skënderbej" dhe Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, kryesisht në funksione arsimore e kulturore.

Ndër këto vajza, përmendim emra si: Vitori Mehmet Kondi-Fico, pjesëtare e LANÇ-it dhe shefe e sektorit të kulturës në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" deri në vitin 1953, Naze Levendi-Dervishi, e cila punoi në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve dhe më pas në sektorin e shëndetësisë, Sofije Kristo dhe Dhora Zenko, që vijuan karrierën për disa vite në strukturat ushtarake, përpara se të zhvendoseshin në sektorët civilë.

Këto gra formuan gjithashtu bazën e ekipit të qitjes të klubit "Partizani", përfaqësues i ushtrisë në arenën sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

Megjithëse numri i grave oficere ishte i kufizuar, ndikimi i tyre ishte i prekshëm. Ato përfaqësonin guximin dhe përkushtimin e vajzave që kishin kaluar nga ilegaliteti, lufta dhe skamja në uniformën e nderuar të oficeresh shqiptare.

Një hap më tej u bë vetëm në vitin 1967, kur mbi 70 vajza nga të gjitha trevat e Shqipërisë nisën studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë, duke shënuar një ndryshim të vonuar, por të rëndësishëm



Oficere për pak kohë, luftëtare përjetë

në integrimin e grave në radhët e ushtrisë së rregullt.

Rrugëtimi i grave oficere të pasluftës është një kapitull i rëndësishëm i historisë sonë ushtarake dhe kombëtare. Ato sfiduan paragjykimet e kohës, kapërcyen barrierat institucionale dhe ndonëse jo gjithmonë në rolin që meritonin, lanë gjurmë të pashlyeshme në themelet e shtetit të ri shqiptar

Gratë Oficere në Zanafillën e Modernizimit të Ushtrisë Shqiptare

Liza Cara-Legisi, një jetë në shërbim të ushtrisë dhe emancipimit të gruas shqiptare

Liza Gjok Cara-Legisi, e lindur në fshatin Perlat të Mirditës, më 1942, përfaqëson një histori të jashtëzakonshme të guximit femëror në një kohë kur normat patriarkale dominonin rëndë në shoqërinë veriore shqiptare. E fejuar në moshë të vogël sipas zakoneve të Kanunit, ajo prishi fejesën dhe u largua nga familja për të ndjekur ëndrrën e saj për arsimim dhe shërbim ushtarak.

Në vitin 1967, ajo regjistrohet ndër të parat vajza në Shkollën e Oficerëve dhe në vitin 1969 diplomohet si oficere e këmbësorisë, duke marrë titullin "Oficere aktive" me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Gjatë 23 viteve të shërbimit, Liza Legisi ka mbajtur pozicione të rëndësishme, përfshirë: Komandante kompanie këmbësorie; Instruktore në Degën e Mobilizimit të Mirditës; Nëndrejtoreshë e shkollës për përgatitjen ushtarake dhe fizike; Instruktore në Shkollën e Lirë Ushtarake (SHLU).

Ajo përfundon karrierën me gradën "Kapiten i

Parë", ndërkohë që ndikimi i saj në shoqëri ka qenë shumë më i gjerë, duke frymëzuar brezat e rinj.

Nevreska Devolli, oficere e palëkundur e këmbësorisë dhe shembull i përkushtimit të heshtur

Nevreska Devolli, e lindur më 9 maj 1942, në Starje të Kolonjës, është një tjetër figurë e rëndësishme që mbetet në kujtesën e ushtrisë si pjesë e brezit të parë të oficerëve femra. E diplomuar në vitin 1969 për këmbësori, Nevreska Devolli-Abazi ka mbajtur për 23 vite rresht detyra me përgjegjësi të lartë në Tiranë, Laç dhe Vlorë, si: Komandante e kompanisë së këmbësorisë; Instruktore për përgatitjen fizike në Divizion; Referente në Drejtorinë Politike të Ushtrisë; Komandante batalioni në RSHA; Nëndrejtoreshë për përgatitjen fiziko-ushtarake. Në vitin 1992, me reformimin e strukturave të ushtrisë, del në rezervë me gradën "Kapiten i Parë". Ndërroi jetë në vitin 2012, duke lënë pas një histori të pasur përkushtimi dhe profesionalizmi.

Trashëgimia

Të dyja këto gra, me rrugëtime që tejkaluan kufijtë gjinorë dhe sfiduan normat e kohës, kontribuan jo vetëm në forcimin profesional të Forcave të Armatosura, por edhe në emancipimin shoqëror të gruas shqiptare.

Historia e tyre përfaqëson një kapitull të rëndësishëm të ndërthurjes mes uniformës, sakrificës dhe përkushtimit të heshtur. Ato mbeten modele frymëzimi për brezat e rinj, për vajzat që sot shërbejnë me dinjitet në ushtrinë shqiptare.



Kryengritja Popullore e Matit: Simbol i Rezistencës Antifashiste Shqiptare

Më datën 31 korrik të vitit 1943, ndërsa nata i linte vend agimit të 1 gushtit, u ndez shkëndija e një ndër ngjarjeve më të lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare në Shqipëri – Kryengritja Popullore e Matit. Sot, 82 vjet më vonë, kujtojmë me nderim këtë moment historik që vulosi pjesëmarrjen e popullit të Matit në betejën për çlirim, duke hyrë me dinjitet në faqet e lavdishme të historisë sonë kombëtare.

Kjo kryengritje, e cila nisi më 31 korrik dhe zgjati deri më 28 gusht 1943, u përgatit me maturi dhe fshehtësi nga prilli deri në korrik të atij viti. Ishte fryt i vendimit të Kuvendit të Bruçit, mbajtur më 26 korrik në shtëpinë e patriotit Ahmet Beqiri në fshatin Bruç. Në këtë kuvend morën pjesë përfaqësues të shtresave të ndryshme shoqërore dhe forcave politike të zonës, në përputhje me idealet e Konferencës së Pezës, për bashkimin e shqiptarëve në një front të përbashkët kundër pushtuesit.

Në këtë kryengritje morën pjesë rreth 3000 luftëtarë të armatosur, nga e gjithë zona e Matit dhe krahinat përreth – Lura, Qafmurra, Selita dhe Kthella. Populli i Matit, si kurrë më parë, ngriti pushkët për lirinë e tij dhe për çlirimin e Atdheut nga thundra fashiste.

Furia e luftës dhe fitoret e popullit

Lufta nisi në mesnatën e 31 korrikut me një sulm të organizuar mbi:

- Garnizonin fashist italian në Burrel
- Burgun e Burrelit, ku u liruan mbi 200 të burgosur politikë
- Kampin e përqendrimit në Koms
- Administratën e nënprefekturës në Burrel

Kryengritësit, të udhëhequr nga shtabi popullor, zhvilluan luftime të ashpra në shumë pika strategjike: Qafshatamë, Pujkë, Suç, Gërman, Batër, Dom, Rripë, Frankth, Gurrë e Vogël, duke dëmtuar ndjeshëm forcat pushtuese.

Bilanci i kësaj lufte flet vetë:

- Mbi 900 ushtarë dhe oficerë fashistë të vrarë apo plagosur
- Kapje e teknologjisë ushtarake dhe sasi të mëdha municionesh
- 19 dëshmorë të rënë në fushën e nderit
- Rreth 200 luftëtarë të plagosur apo gjymtuar

Çmimi për këtë fitore që i rëndë: u dogjën 19 fshatra, u shkatërruan të mbjellat dhe të korrat, u dëmtuan mijëra krerë bagëti dhe 3000 koshere bletësh, ndërkohë që humbjet financiare u vlerësuan në 1603 dollarë për frymë, një shifër e lartë për atë kohë.

Lavdi dëshmorëve dhe trashëgimisë së tyre!

Ata që ranë në këtë kryengritje vijnë nga të gjitha shtresat shoqërore të Matit – burra dhe gra që zgjodhën të jetojnë në përjetësi përmes gjakut dhe sakrificës. Ata nuk panë me sytë e tyre ditën e çlirimit, por ishin ata që e parashikuan dhe e bënë të mundur atë me idealet, vendosmërinë dhe gjakun e tyre.

Populli i Matit, me këtë kryengritje të lavdishme, dha një shembull të rrallë përkushtimi dhe guximi, duke u bërë pjesë e pandashme e Luftës Nacionalçlirimtare dhe duke forcuar themelet e Shqipërisë së lirë.

Nder dhe mirënjohje brez pas brezi për luftëtarët e lirisë!

Gëzuar 82-vjetorin e çlirimit të Burrelit nga pushtimi nazifashist!



KJO KRYENGRITJE, E CILA NISI MË 31 KORRIK DHE ZGJATI DERI MË 28 GUSHT 1943, U PËRGATIT ME MATURI DHE FSHEHTËSI NGA PRILLI DERI NË KORRIK TË ATIJ VITI. ISHTE FRYT I VENDIMIT TË KUVENDIT TË BRUÇIT, MBAJTUR MË 26 KORRIK NË SHTËPINË E PATRIOTIT AHMET BEQIRI NË FSHATIN BRUÇ. NË KËTË KUVEND MORËN PJESE PËRFAQËSUES TË SHITRESAVE TË NDRYSHME SHOQËRORE DHE FORCAVE POLITIKE TË ZONËS, NË PËRPUTHJE ME IDEALET E KONFERENCËS SË PEZËS, PËR BASHKIMIN E SHQIPTARËVE NË NJË FRONT TË PËRBASHKËT KUNDËR PUSHTUESIT.



Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, mori pjesë në një takim online të Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës (UDCG). Takimi u organizua nga Ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius, dhe Sekretari i Mbrojtjes i Mbretërisë së Bashkuar, John Healey.

Duke folur para Ministrave të Mbrojtjes që morën pjesë në takim, Sekretari i Përgjithshëm theksoi iniciativën që ai dhe Presidenti i SHBA-së Donald J Trump njoftuan javën e kaluar për të rritur mbështetjen për Ukrainën duke hapur asete shtesë amerikane për Ukrainën përmes investimeve nga Aleatët në Evropë dhe Kanada. Kjo iniciativë e re është e hapur dhe tashmë ka parë shumë Aleatë të shprehin interes për të kontribuar. Ajo plotëson një sërë iniciativash të tjera përmes të cilave Aleatët mbështesin Ukrainën dhe ofron qasje të re në pajisjet dhe teknologjinë amerikane që Ukraina ka kërkuar për dorëzim urgjent. Kjo përpjekje vullnetare do të koordinohet nga NATO, duke pasur parasysh përvojën dhe infrastrukturën që ofron Aleanca, duke përfshirë edhe përmes komandës së saj në Wiesbaden, Gjermani - Ndhimja dhe Trajnimi i Sigurisë së NATO-s për Ukrainën (NSATU) - që tashmë po koordinon mbështetjen për Ukrainën dhe ka qendra logjistike në pjesën lindore të Aleancës. UDCG gjithashtu do të vazhdojë të luajë një rol jetësor.

Kjo iniciativë dhe të tjera bashkojnë tre vendimet kryesore të marra nga udhëheqësit në Samitin e NATO-s në Hagë vetëm disa javë më parë: rritja e investimeve në mbrojtje, rritja e prodhimit të mbrojtjes dhe mbështetja e Ukrainës. Qëllimi i gjithë ndihmës së sigurisë së Aleatëve për Ukrainën është që konflikti të marrë një fund të drejtë dhe të qëndrueshëm sa më shpejt të jetë e mundur.

Mbështetja e NATO-s për Ukrainën ka qenë një nga shtyllat kryesore të solidaritetit ndërkombëtar kundrejt agresionit rus që nga viti 2022. Që në fillim të pushtimit, NATO ka dënuar ashpër veprimet e Rusisë dhe ka mobilizuar një gamë të gjerë ndihmash për të ndihmuar Ukrainën të mbrojë sovranitetin dhe integritetin e saj territorial. Kjo mbështetje nuk e bën NATO-n palë në konflikt, por përforcon të drejtën e Ukrainës për vetëmbrojtje, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

Një nga format kryesore të ndihmës është Paketa e Ndhimës Gjithëpërfshirëse (CAP), e cila përfshin ndihma jo-vdekjeprurëse si pajisje mjekësore, veshje ushtarake, gjeneratorë, automjete logjistike dhe mbështetje për rindërtimin e sektorit të mbrojtjes ukrainas. Kjo paketë është përforcuar në samitet e NATO-s në Madrid (2022), Vilnius (2023) dhe Washington (2024), duke u shndërruar në një program shumëvjeçar që synon modernizimin e forcave të armatosura ukrainase dhe rritjen e ndërveprueshmërisë me NATO-n.

Në vitin 2024, NATO krijoi Komandën për Ndhimë dhe Trajnim për Ukrainën (NSATU), me seli në Wiesbaden, Gjermani. Ky strukturim i ri koordinon trajnimin e trupave ukrainase në vendet aleate, menaxhon dhurimet e pajisjeve ushtarake dhe mbështet riparimin e tyre. NSATU përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të mbështetjes afatgjatë për Ukrainën, duke e vendosur atë në një rrugë të qartë drejt integritetit të plotë me strukturat e NATO-s.

Përveç ndihmës praktike, NATO ka shprehur mbështetje politike për anëtarësimin e ardhshëm të Ukrainës në Aleancë. Në samitin e Vilniusit, u vendos që Ukraina nuk ka më nevojë për një Plan Veprimi për Anëtarësim (MAP), duke e afruar më shumë me statusin e anëtarit të plotë. Megjithatë, procesi mbetet i kushtëzuar nga përfundimi i konfliktit dhe konsensusi i të gjitha vendeve anëtare.

Mbështetja e NATO-s për Ukrainën është e gjerë, e strukturuar dhe në evolucion të vazhdueshëm. Ajo përfshin ndihmë materiale, trajnime, mbështetje politike dhe një angazhim të qartë për të ndihmuar Ukrainën të mbrohet dhe të integrohet në arkitekturën e sigurisë euroatlantike.

Përfaqësia e NATO-s në Ukrainë

Përfaqësia e NATO-s në Ukrainë (NRU) lehtëson dialogun dhe bashkëpunimin politik dhe ushtarak midis Aleancës dhe Ukrainës, dhe koordinon mbështetjen praktike të NATO-s për Ukrainën.

Një rol kyç i NRU-së është të ofrojë ndihmë këshillimore për sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes së Ukrainës, duke ndihmuar Ukrainën të kalojë forcat e saj të armatosura drejt ndërveprimit të plotë me NATO-n dhe të zbatojë Programin e saj Vjetor Kombëtar të adaptuar. NRU është gjithashtu një palë kryesore e interesuar në koordinimin e Paketës Gjithëpërfshirëse të Ndhimës, kuadri gjithëpërfshirës përmes të cilit NATO ofron mbështetje praktike për Ukrainën, dhe drejton komunikimet

Takimi i Grupit të Kontaktit: NATO prezanton mundësi të reja për ndihmë ndaj Ukrainës



publike të NATO-s në Ukrainë.

Detyrat kryesore të NRU-së përfshijnë: mbajtjen e kontaktit me ministritë dhe agjencitë ukrainase, përmirësimin e dialogut politik dhe ushtarak NATO-Ukrainë;

këshillimin e autoriteteve ukrainase mbi aktivitetet në mbështetje të partneritetit dhe reformave NATO-Ukrainë, në veçanti Ministrinë e Punëve të Jashtme, Mbrojtjes dhe Brendshme, Këshillin e Sigurisë dhe Mbrojtjes Kombëtare, Shërbimin e Sigurisë së Ukrainës, Parlamentin dhe organizatat joqeveritare;

rritjen e ndërgjegjësismit dhe të kuptuarit të NATO-s në Ukrainë; informimin e publikut ukrainas rreth aktivitetëve kryesore në bashkëpunimin NATO-Ukrainë; dhe ofrimi i këshillave dhe mbështetjes për institucionet ukrainase në fushën e zhvillimit të aftësive strategjike të komunikimit.

Ndërsa NATO dhe Ukraina vazhdojnë të intensifikojnë bashkëpunimin e tyre dhe të forcojnë integrimin politik të Ukrainës me NATO-n, Aleanca ka përforcuar NRU-në dhe ka zgjeruar nivelet e stafit të saj në zyrën në Kiev. Për këtë qëllim, në korrik 2024, Sekretari i Përgjithshëm emëroi një Përfaqësues të Lartë të NATO-s për të drejtuar NRU-në dhe për të vepruar si një pikë qendrore për angazhimin e NATO-s me autoritetet ukrainase në Kiev.

NRU u krijua në shtator 2015 duke bashkuar dy zyra ekzistuese: Qendrën e Informacionit dhe Dokumentacionit të NATO-s (NIDC) dhe Zyrën Ndërlidhëse të NATO-s (NLO). NIDC u përfundua në Kiev në maj 1997 për të mbështetur përpjekjet për të informuar publikun ukrainas rreth aktivitetëve të NATO-s dhe përfitimeve të bashkëpunimit NATO-Ukrainë.

Pjesë e Zyrës së Informacionit dhe Shtypit të NATO-s (tani Divizioni i Diplomacisë Publike), ishte zyra e parë e informacionit e themeluar nga NATO në një vend partner dhe e hapur për publikun e gjerë. NLO u krijua në Kiev në prill të vitit 1999 për të lehtësuar pjesëmarrjen e Ukrainës në programin e Partneritetit për Paqe (PfP) dhe për të mbështetur përpjekjet e Ukrainës në fushën e reformës së mbrojtjes.

Evolucioni i marrëdhënieve NATO-Ukrainë

Marrëdhëniet NATO-Ukrainë u lançuan zyrtarisht në vitin 1991, kur vendi i ri i pavarur u bashkua me Këshillin e Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC), një forum për dialog dhe bashkëpunim midis Aleatëve të NATO-s dhe ish-kundërshtarëve të tyre të Paktit të Varshavës. Disa vjet më vonë, në vitin 1994, Ukraina u bashkua

me Partneritetin për Paqe (PfP), një program bashkëpunimi praktik dypalësh midis vendeve partnere individuale dhe NATO-s. Ishte një nga anëtarët themelues të Këshillit të Partneritetit Euro-Atlantik (EAPC), i cili zëvendësoi NACC në maj 1997.

Karta e korrikut 1997 mbi një Partneritet të Veçantë mbetet themeli themelor që mbështet marrëdhëniet NATO-Ukrainë. Karta krijoi Komisionin NATO-Ukrainë si organin kryesor përgjegjës për avancimin e marrëdhënieve NATO-Ukrainë. Komisioni drejtoi aktivitetet bashkëpunuese dhe ofroi një forum për konsultime midis Aleatëve dhe Ukrainës mbi çështjet e sigurisë me interes të përbashkët.

Deklarata për Plotësimin e Kartës, e nënshkruar në vitin 2009 si një vazhdim i vendimeve të marra në Samitin e NATO-s të vitit 2008 në Bukuresht, i dha Komisionit një rol qendror në thellimin e dialogut politik dhe bashkëpunimit për të mbështetur përpjekjet e Ukrainës për reforma në lidhje me aspiratat e saj euroatlantike për anëtarësim në NATO. Mjeti kryesor për të mbështetur këtë proces është Programi Kombëtar Vjetor (ANP), i cili pasqyron objektivat kombëtare të reformës së Ukrainës dhe planet vjetore të zbatimit. ANP është përbërë nga pesë kapituj që përqendrohen në: çështjet politike dhe ekonomike; çështjet e mbrojtjes dhe ushtarake; burimet; çështjet e sigurisë; dhe çështjet ligjore. Kjo përfshin reformat që lidhen me qeverisjen e mirë, luftën kundër korrupsionit, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes, në përputhje me parimet dhe standardet euroatlantike.

Aleatët vlerësojnë progresin sipas ANP-së çdo vit. Përgjegjësia për zbatimin e tij bie kryesisht mbi Ukrainën. Komisioni për Koordinimin e Integritetit Euroatlantik të Ukrainës, i kryesuar nga Zëvendëskryeministri për Integrimin Evropian dhe Euroatlantik, siguron koordinimin e përgjithshëm të zbatimit të tij nga organet shtetërore. Në vitin 2023, Këshilli NATO-Ukrainë u krijua si pasardhës i Komisionit NATO-Ukrainë. Ndryshimi nga Komisioni në Këshill tregon forcimin e lidhjeve politike dhe integrimin në rritje të Ukrainës me NATO-n. Në formatin e Këshillit, Ukraina ulet përkrah të gjitha shteteve anëtare të NATO-s si një pjesëmarrëse e barabartë. Këshilli mund të thirret nga Sekretari i Përgjithshëm, si dhe nga pjesëmarrësit e tij individualë, përfshirë Ukrainën, për konsultime për kriza. Takimi inaugurues i Këshillit NATO-Ukrainë u zhvillua më 12 korrik 2023 në Samitin e Vilniusit.

Burimi: www.nato.int/

REFUZIMI I 1 MILIARD DOLLARËVE: Misioni i inteligjencës artificiale i MIRA MURATIT që nuk mund të blihej me para

Mira Murati, një inxhinieri vizionare shqiptaro-amerikane dhe ish-drejtoreshë teknologjike e OpenAI, themeloi “Thinking Machines Lab” në vitin 2025, për të ndërtuar inteligjencë artificiale transparente dhe të orientuar drejt njeriut. Kur Meta e Mark Zuckerberg ofroi mbi 1 miliard dollarë për të rekrutuar të gjithë ekipin e saj, të gjithë refuzuan - jo për para, por për besim në misionin dhe leadershipin e Muratit.

Në peizazhin e inteligjencës artificiale që evoluon me shpejtësi sot, Mira Murati është bërë një nga njerëzit më të admiruar dhe me ndikim, jo për shkak të deklaratave publike apo intervistave virale, por për shkak të vizionit, besimit dhe përkushtimit që ajo ngjall, shkruan “Entertainment Times”. Kur u përhapën lajmet se Mark Zuckerberg po paguante 1 miliard dollarë për të transferuar të gjithë ekipin e saj në laboratorin e inteligjencës artificiale të Metës, dhe të gjithë e refuzuan, kjo shkaktoi tronditje në Silicon Valley. Pse disa nga yjet më të ndritshëm në IA do të refuzonin një pagë kaq të madhe? Për ta kuptuar këtë, duhet të mësojmë se kush është Mira Murati dhe çfarë po krijon ajo.

Nga Vlora në Silicon Valley

E lindur në Vlorë, Shqipëri, në vitin 1988, Mira Murati nuk pati famën e teknologjisë të lënë pas dore. Ajo u largua nga shtëpia në moshën 16 vjeç me një bursë në “United World Colleges” në Kanada dhe më pas vazhdoi të merrte një degë të dyfishtë në inxhinieri mekanike dhe arte liberale nga “Dartmouth College” dhe “Colby College.”

Jeta e saj profesionale filloi në “Goldman Sachs”, “Zodiac Aerospace” dhe “Tesla”, ku bashkëpunoi në Model X dhe versionet e hershme të Autopilot. Ajo ishte gjithashtu në Leap Motion, duke u përqendruar plotësisht në AR/VR, dhe më pas u bë punonjëse e OpenAI në vitin 2018.

Forca lëvizëse modeste pas ChatGPT dhe më gjerë

Ndërsa emra si Sam Altman shpesh marrin vëmendjen, njerëzit e brendshëm dhe studiuesit e dinë se Mira ishte shtylla kurrizore teknike dhe strategjike pas produkteve kryesore të OpenAI: ChatGPT, DALL•E, Codex dhe punës themelore që do të çonte në GPT-4 dhe GPT-4o multimodale në kohë reale.

Në vitin 2022, ajo u bë Drejtoreshë e Teknologjisë. Gjatë sagës së trazuar të bordit të OpenAI në nëntor 2023, kur Altman u shkarkua për një kohë të shkurtër, Mira u ngjit si CEO e përkohshme dhe e mbajti anijen të qëndrueshme. Edhe Altman më vonë e pranoi leadershipin e saj jetësor në ruajtjen e moralit të brendshëm dhe mbrojtjen e misionit të OpenAI.

Ndërtimi i diçkaje të re: Laboratori i makinës së të menduarit

Në fillim të vitit 2025, Mira e befasoi botën e AI-së duke u larguar nga OpenAI për të filluar kompaninë e saj “Thinking Machines Lab”, një korporatë me përfitim publik të dedikuar për krijimin e “AI-së së hapur, të interpretueshme dhe të orientuar drejt njeriut”.

Brenda disa javësh, kompania kishte mbledhur 2 miliardë dollarë me një vlerësim prej 12 miliardë dollarësh. Investitorët e hershëm përfshinin Nvidia, Cisco, Andreessen Horowitz. Por më mbresëlënëse se paratë ishte ekipi që ajo ndërtoi - një grup ish-



studentësh të OpenAI, studiuesish të nivelit të lartë dhe ekspertësh të sigurisë. Shumica e tyre kishin punuar së bashku për vite me radhë dhe nuk po hidheshin thjesht në një startup të ri; ata po vazhdonin vizionin me Muratin.

Hyrja e Zuckerberg: oferta prej 1 miliard dollarësh

Në mesin e vitit 2025, pati raportime lajmesh se Mark Zuckerberg dhe Meta kishin tentuar të rekrutonin të gjithë ekipin udhëheqës të Mirës me një ofertë të vlerësuar prej më shumë se 1 miliard dollarësh, një paketë aksionesh, pagash dhe stimulsh zhvendosjeje. Lëvizja ishte e drejtpërdrejtë: të blihej talenti i “Thinking Machines” nën ombrellën e Meta AI dhe të përshpejtoheshin planet e Zuckerberg në AI me burim të hapur.

Por diçka shkoi keq. Të gjithë thanë jo. Asnjë studiues ose inxhinier kryesor nuk kaloi te Meta, as për pagesën e madhe.

Nuk ishte besnikëri, ishte besim

“Thinking Machines Lab” nuk ishte vetëm një biznes; ishte një mentalitet. Kompania është e përkushtuar për të krijuar mjete të AI-së që janë transparente, të personalizueshme dhe në interes të publikut - dhe jo thjesht fitim komercial ose madhësi

algoritmike. E udhëhequr nga Mira, firma është zotuar të publikojë dokumentacionin teknik, burimet e të dhënave të trajnimit dhe madje të hapë pjesë të modeleve të saj, të cilat kompanitë e mëdha të teknologjisë i shmangin.

Më shumë se kaq, punonjësit flasin për besim dhe qëllim të përbashkët. Ata thonë se Murati dëgjon, nuk shkurton rrugën për shpejtësi dhe këmbëngul që siguria të integrohet në model që nga dita e parë. Kjo kulturë është e qetë, e drejtuar nga misioni dhe e përqendruar te përdoruesi - nuk përputhej me qasjen e Metës.

Çfarë do të thotë kjo për të ardhmen e IA-së?

Refuzimi i një oferte prej 1 miliard dollarësh dërgon një mesazh më të gjerë: vizioni mbizotëron mbi paratë, të paktën për disa. Në një kohë kur talenti teknologjik joshet nga ofertuesi më i lartë, besnikëria e ekipit Murati tregon një ndryshim në mënyrën se si mendjet më të mëdha po mendojnë për IA-në.

Mira Murati është bërë një lloj i pazakontë udhëheqëseje teknologjike - introverte, tepër e aftë dhe e respektuar. Refuzimi për t’ia shitur Metës ishte më shumë sesa një fitore personale. Ishte një pikë kthese në luftën për shpirtin e IA-së. Dhe në këtë luftë, duket se Murati dhe kolegët e saj po vizatojnë kufij me saktësi dhe guxim.

Shkencëtarët krijojnë një “kompjuter të gjallë” të bërë nga qelizat e trurit të njeriut

Kur fantastiko-shkencorja bëhet realitet

“Cortical Labs”, një kompani teknologjike australiane e re, ka lançuar “kompjuterin e parë biologjik të komercializuar” të bërë nga qelizat e trurit të njeriut në një konferencë në Barcelonë, raportoi “ABC News Australia”.

Kompania australiane “Cortical Labs” ka prezantuar një kompjuter krejtësisht unik, të quajtur CL1, në një konferencë në Barcelonë. Ai nuk funksionon si kompjuterët tradicionalë; në vend të mikroprocesorëve, përdor qeliza të trurit të njeriut të kultivuara në laborator për të kryer llogaritje dhe për të marrë vendime. Qelizat vendosen mbi një çip silikoni dhe ndërveprojnë në kohë reale përmes një sistemi të quajtur BIOS, i cili interpreton sinjalet elektrike që qelizat dërgojnë dhe marrin. Ky sistem është i pajisur me mekanizma që e mbajnë “tru-kompjuterin” të gjallë deri në gjashtë muaj.

Ky kompjuter është shumë më efikas se AI-ja tradicionale, sepse qelizat e trurit mësojnë dhe përshtaten në mënyrë më të shpejtë, duke konsumuar më pak energji. Ai gjithashtu ofron mundësi të reja për kërkimin shkencor, si testimi i barnave apo modelimi i sëmundjeve neurologjike. Për më tepër, ky sistem ka mësuar të luajë Pong — një lojë klasike — duke treguar se mund të zhvillojë sjellje të orientuar drejt qëllimeve.

Me këtë teknologji, “Cortical Labs” ka hapur rrugën drejt një epoke të re ku kompjuterët nuk janë më thjesht makineri; ata janë krijesa hibride, që bashkojnë biologjinë me elektronikën. Nëse ky është vetëm fillimi, mund të imagjinojmë një të ardhme ku kufiri midis njeriut dhe makinës bëhet gjithnjë e më i paqartë.

AI-ja e re?

Ekipi që qëndron pas saj beson se mund të përdoret si një lloj AI-je e thjeshtë biologjike, por të tjerë janë të kujdesshëm në lidhje me potencialin e teknologjisë.

CL1, kompjuteri biologjik i krijuar nga “Cortical Labs”, është e para nga krijuesi i tij si një formë e re e inteligjencës artificiale — por jo në kuptimin tradicional. Ata e quanin “inteligjencë biologjike sintetike”, sepse sistemi nuk simulohet nga softuer, por funksionon mbi qelizat e vërteta që mësojnë dhe përshtaten në kohë reale. Kjo e bën CL1 të aftë për të kryer detyra të thjeshta si lojëra, por edhe për të reaguar ndaj stimulimit në mënyrë dinamike, duke pasur shumë më pak energji se sistemet tradicionale të AI-së.

Megjithatë, jo të gjithë janë të lidhur për potencialin e tij. Disa shkencëtarë paralajmërojnë se, ndonëse qelizat kanë aftësinë për të mësuar, kjo nuk do të thotë se kemi bërë një formë të vërtetë inteligjence. Të mësosh Pong është një gjë, por të marrësh vendime komplekse kërkon një nivel më të lartë të përpunimit konjitiv. Ka edhe një sistem tjetër etik: kur një sistemologjik mëson dhe është thjesht një mjet, apo i afrohet diçkaje të tillë?

“Cortical Labs” ka disa kufizime për keqkuptimet, duke theksuar se qelizat nuk janë të vetëdijshme dhe nuk shohin ndjesi. Por debati mbetet i hapur. Teknologjia është e re, e krijuar dhe potencialisht transformuese — por kërkon kujdes, transparencë dhe një kuptim të thellë të asaj që po ndërtojmë. Nëse CL1 është një hap drejt një forme të re të inteligjencës, atëherë jemi në prag të një epoke që biologjia dhe teknologjia nuk janë bashkë por jetojnë në të njëjtin sistem.

Eksperimentet përfundimtare

Për ta arritur këtë, studiuesit që fshihen pas prototipit kaluan gjashtë vjet duke zhvilluar grupe të vogla neuronesh. Në vitin 2022, ata arritën të krijojnë një “mini-tru” kompjuterik që përshtatet vetë duke kombinuar 800,000 neurone njerëzore dhe minjsh në një çip.

Neuronet e kultivuara

Të rritura në laborator nga qelizat e gjakut, neuronet “mbahen gjallë në një enë që i ushqen ato me lëndë ushqyese dhe i mban larg mikrobet e padëshiruara”, shpjeguan studiuesit.

Një tru miniaturë

Nga ana tjetër, çipat e silikonit dërgojnë sinjale elektrike te neuronet nëpërmjet elektrodave të vogla dhe kapin përgjigjet e tyre në këmbim, si një tru miniaturë.

Bashkimi i biologjisë dhe shkencës kompjuterike

“Kjo teknologji bashkon biologjinë me informatikën tradicionale për të krijuar makinën përfundimtare të të mësuarit.



KOMPANIA AUSTRALIANE “CORTICAL LABS” KA PREZANTUAR NJË KOMPJUTER KREJTËSISHT UNIK, TË QUAJTUR CL 1, NË NJË KONFERENCË NË BARCELONË. AI NUK FUNKSIONON SI KOMPJUTERËT TRADICIONALË; NË VEND TË MIKROPROCESORËVE, PËRDOR QELIZA TË TRURIT TË NJERIUT TË KULTIVUARA NË LABORATOR PËR TË KRYER LLOGARITJE DHE PËR TË MARRË VENDIME. QELIZAT VENDOSËN MBI NJË ÇIP SILIKONI DHE NDERVEPROJNË NË KOHË REALE PËRMES NJË SISTEMI TË QUAJTUR BIOS, I CILI INTERPRETON SINJALET ELEKTRIKE QË QELIZAT DËRGOJNË DHE MARRIN. KY SISTEM ËSHTË I PAJISUR ME MEKANIZMA QË E MBAJNË “TRU-KOMPJUTERIN” TË GJALLË DERI NË GJASHTË MUAJ.

Media “New Atlas”, e cila raportoi në ambientet e kompanisë, vuri në dukje se CL1 “mëson aq shpejt dhe në mënyrë fleksibile saqë i tejkalon plotësisht çipat e inteligjencës artificiale me bazë silikoni të përdorur për të trajnuar modelet ekzistuese të mëdha gjuhësore si ChatGPT”.

Plotësues me AI-në

Prandaj, “Cortical Labs” po propozon një “inteligjencë biologjike sintetike”, e cila do të ishte e aftë të marrë vendime komplekse nga një sasi e vogël të dhënash, ndryshe nga sistemet ekzistuese.

Inteligjencia njerëzore e riprodhuar

Kjo është një detyrë që “njerëzit, minjtë, macet dhe zogjtë mund ta bëjnë (por jo inteligjencia artificiale për momentin”, shpjegoi Brett Kagan, drejtori shkencor i Cortical Labs, i cili u citua nga ‘ABC News’.

Një zgjidhje më efikase nga ana energjetike

Ky biokompjuter i ri ka gjithashtu avantazhin e të qenit më pak energji-intensiv sesa motorët e tjerë të inteligjencës artificiale, ndërsa konsumi i lartë i Chat GPT shpesh kritikohet. CL1 i kryen të gjitha detyrat e tij me vetëm 20 vat.

Prototipa të tjerë

Cortical Labs nuk është i vetmi laborator që zhvillon kompjuterë hibridë: Startup-i zviceran FinalSpark zhvilloi një biokompjuter të përbërë nga 16 mini tru njerëzorë në vitin 2024, ndërsa Universiteti Johns Hopkins po eksploron integrimin e organoideve të trurit në makina.

Kufijtë e sistemit

Megjithatë, disa ekspertë të IA-së janë skeptikë, siç është specialisti francez i rrjeteve nervore artificiale, Claude Touzet, i cili beson se këto sisteme janë të paafta të kryejnë llogaritje inteligjente sepse organizimi i neuroneve në makina nuk është i njëjtë me atë në trurin e njeriut.

Pengesa biologjike

“Pa përmendur që proceset biologjike kanë kohë reagimi të ngadalta, që neuronet lodhen dhe nuk mund të tolerojnë të nxehtin ose të ftohtin”, shkroi Touzet në gazetën franceze “L’Express” në vitin 2023.

A është rishpikur informatika?

“Ky nuk është thjesht një kompjuter i ri. Është rishpikur informatika”, citohet të kenë thënë drejtuesit e kompanisë nga ‘Usbek and Rica’.

ATDHEU NDERI DETYRA



SKANO QR CODE

PËR MË SHUMË INFORMACION
MBI PROGRAMET E AFA DHE
PROCEDURAT E APLIKIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURAS
ARMED FORCES ACADEMY

www.mod.gov.al

**Hapet aplikimi për
programet e
studimit në
Akademinë e
Forcave të**

Armatosura (AFA)

Nga data 29 korrik
deri më 3 gusht 2025
Apliko në portalin
zyrtar: ualbania.al
Akademia e Forcave
të Armatosura ju fton
të bëheni pjesë e saj
përmes përzgjedhjes
së një prej 4
programeve të
akredituara në
fushën e mbrojtjes
dhe sigurisë:

1. **Shkenca
Ushtarake**
2. **Teknologji
Informacioni dhe
Komunikimi në
fushën e
Mbrojtjes**
3. **Marrëdhënie
Ndërkombëtare
në fushën e
Mbrojtjes**
4. **Shkenca
Komunikimi**

Nëpërmjet portalit
ualbania.al, çdo
maturant ka të drejtë
të aplikojë dhe të
përzgjedhë deri në **10
programe studimi** në
universitetet publike
shqiptare, përfshirë
Akademinë e Forcave
të Armatosura.
Zgjidh AFA, formohu
si profesionist dhe
kontribuo për
atdheun!
Mos e humb afatin!
Aplikimi mbyllet më 3
gusht 2025.

MATURANTË VENDOSNI TË ARDHMEN TUAJ NË SHËRBBIM TË ATDHEUT!

APLIKOOONLINE #29KORRIK #3GUSHT #AFA #THIRRJEZYRTARE #SHËRBBIMPËRATDHEUN
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURAS — MË SHUMË SE NJË SHKOLLË, NJË MISION!